




EJMEN SHABAN

VIRUSI RONA

KËSHILLA DHE MËSIMË

Përktheu: RASHIT ZYLFIU



Gjilan, 2020

Autor: Ejmen SHABAN

Përktheu: Rashit ZYLFIU

Titulli: VIRUSI CORONA KËSHILLA DHE MËSIMI

Recensent: Dr. Sedat ISLAMI

Redaktor gjuhësor: Arjan KOÇI

Ballina & radhitja kompjuterike: Avni G. GASHI

Boton: www.rashitzylfiu.com

Tirazbi: 1000

Botimi i parë: Prill, 2020 /1441h

©Të gjitha të drejtat të rezervuara për përkthyesin.

Info:

Posta elektronike: rashitzylfiu@gmail.com

www.rashitzylfiu.com

HYRJE

Falënderimi i takon Allahut, që vepron dhe gjykon çfarë të dojë. Dëshmojmë dhe deklarojmë se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë pos Allahut dhe dëshmojmë dhe deklarojmë se Pejgamberi Muhamed është rob dhe i Dërguar i Tij. Ai ishte thirrës në adhurimin vetëm të Zotit, paqja dhe begatitë e Zotit qofshin mbi të, mbi familjen dhe mbi shokët e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Metodologjia kur'anore dhe udhëzimi profetik udhëzojnë për edukim përmes ndodhive e ngjarjeve dhe përfitim prej këtyre rasteve për ngritjen e ambicieve dhe mbjelljen e vlerave, për korigjim të kuptimeve dhe ngulitje të imanit, për marrje të këshillave dhe mësimave dhe përdorim të tyre për orientimin dhe rregullimin e gjendjes së njerëzve, për lidhje të vetvetes me veprën e jo me rezultatet dhe për preokupim me zgjidhjen dhe frytet e jo me shkaqet dhe problemet.

Virusi Corona (sëmundja Covid-19) është një virus që këto ditë është përhapur jashtë mase mes njerëzve. Ky virus, i cili nuk shihet me sy, ka bërë ndryshime drastike në jetën e njerëzve dhe ka shk-

aktuar panik dhe frikë, madje për shkak të tij janë zbatuar vendime dhe procedura të rrepta, si mbyllja e shkollave, e universiteteve, e aeroporteve dhe e vendeve të grumbullimit të njerëzve, janë mbyllur madje edhe xhamitë dhe faltoret. Sfidat po vazhdojnë ende, ndërkohë që shifrat dhe lajmet po e mbajnë gjallë këtë krizë.

Virusi Corona është shndërruar në bisedë ditore kudo, në programe televizive dhe rrjete sociale. Por, dy pyetje tejet të rëndësishme parashtrohen: A mjafton që ne të jemi vetëm bartës lajmesh dhe analizash? A ka gjëra më të rëndësishme dhe më madhështore nga të cilat duhet të marrim mësim, këshilla e urtësi?

Nuk ka dyshim se në krijesat e Zotit, në ndryshimin e ndodhive dhe ngjarjeve ka këshilla për ata që dëshirojnë t'i marrin ato, ka nxitje për përkujtim dhe vigjilencë.

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿إِنَّ فِي ذَلِكَ لَعِبْرَةً لِّأُولِي الْأَبْصَارِ﴾

“Dhe në këtë, me të vërtetë, ka mësim për ata që shohin.” [Nur: 44]

Besimtari duhet t'i shikojë ngjarjet me precizitet, thellësi dhe këshillë. Marrja e mësimave dhe këshillave është prej suneteve të braktisura dhe në të njëjtën kohë është adhurim madhor.

Ebu Derdaja thotë: “*Të meditosh një orë është më e mirë sesa të falesh natën.*”

Para se të fundoset dhe të preokupohet me lajme, shkaqe, shifra dhe preventivave materiale për këtë sëmundje dhe të tjera, muslimani duhet të marrë mësim dhe këshilla prej ndodhive dhe sprovave.

Ejmen Shaban
20 Rexhep, 1441h
15 Mars, 2020

FJALA E PËRKTHYESIT

Falënderimet i takojnë të madhit Zot, që me dhuntitë e Tij plotësohen punët e mira. Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi Pejgamberin Muhamed, mbi familjen e tij, mbi shokët dhe të gjithë pasuesit e tij deri në kiamet.

Jo rastësisht është thënë se kohët e vështira nxjerrin në pah margaritarë, që shpesh as nëpër mend nuk na ka shkuar për to. Ky libër do të mbetet ndër kujtimet e mira për mua dhe për të gjithë lexuesit nga ditët e karantinës 2020, për shkak të virusit Corona (sëmundja Covid-19), që na izolojoi.

Në ditët e para të izolimit hasa në këtë libër “Virusi Corona, këshilla dhe mësimë” të autorit Ejmen Shaban. Në momentin që fillova ta shfletoja, u ngjall edhe dëshira që këtë libër për shkak të situatës ta sillja edhe në gjuhën shqipe.

Lexues të nderuar!

Ky është një libër tejet aktual për shkak se lidhet me njërën nga ngjarjet e kohës, që na ka përfshirë të tërë dhe në të njëjtën kohë është më shumë se një libër sepse është udhërrëfyes për besimtarët, se

si të gjenden dhe t'i tejkalojnë këto sfida me këshillat dhe mësimet që autori ka shkruar.

Libri fillon me hyrjen, ku autori tregon motivet dhe arsytet pse filloi ta shkruante këtë libër, pastaj menjëherë jep njëzet këshilla dhe mësimet tejet praktike, të cilat fillojnë me një ajet kur'anor dhe më pas argumentohen me fjalët e Pejgamberit ﷺ¹ dhe të dijetarëve të hershëm e të atyre bashkëkohorë.

Për t'ia lehtësuar lexuesit dhe për ta kuptuar më lehtë këshillën, unë si përkthyes i kam vendosur një titull çdo këshille.

Më pas autori kalon te pjesa e dytë, “Mburojat parandaluese sheriatike prej sëmundjeve abstrakte dhe konkrete”, mburoja të cilat besimtarëve ua ka garantuar feja islame dhe autori i sjell me argumente nga Kur'ani dhe Suneti.

Autori e mbyll librin me “Udhërrëfyesin” përmbledhës, i cili na ndihmon të kuptojmë pozicionin tonë kur na prekin sëmundjet dhe si të jemi sa më

¹ Pas shkrimit ose përmendjes së emrit të Pejgamberit Muhamed shkruhet ose thuhet fraza *alejhiselam* (paqja qoftë mbi të!), të cilën në libër do ta hasni në origjinal, në gjuhën arabe.

produktivë, që të dimë si të përfitojmë nga këto ndodhi e të mos bëhemi barrë më e madhe sesa vetë sëmundja apo sprova.


Lexues të nderuar!

Sikur ta takoja autorin një ditë, në emër timin dhe tuajin do e falënderoja nga zemra. Lus Zotin ta shpërblejë për këtë kontribut. Ndoshta një ditë takohemi, i thyejmë kufijtë e distancës dhe bisedojmë për kujtimet e librit “Virusi Corona, këshilla dhe mësimë”.

MA. Rashit ZYLFIU

20.04.2020

Nga karantina, 2020, Gjilan



VIRUSI CORONA
KËSHILLA DHE MËSIME

Këshilla 1:

ZOTI YT ËSHTË I PLOTFUQISHËM

Allahu ﷻ² thotë në Kur'an:

﴿وَمَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ﴾

“Ata nuk e njohin Allahun si duhet.” [En'amë: 91]

Ky virus, kjo krijesë e dobët që shihet vetëm përmes mikroskopit, ka shkaktuar panik dhe frikë në pjesën më të madhe të botës. Kjo njëherazi është fakt për madhësinë e Zotit dhe dobësinë e njerëzimit, i cili edhe pse ka arritur zhvillim në industri, teknologji, ushtri e mjekësi, nuk del nga rrethi i dobësisë dhe i paaftësisë njerëzore. Zoti është i plotfuqishëm dhe forca i takon madhërisë së Tij në tërësi. Argument për këtë janë fjalët e Tij:

﴿وَمَا أوتِيتُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا﴾

“... kurse juve ju është dhënë fare pak dije.” [Isra: 85]

² Në arabisht *xhel-le xhelaluhu*, në gjuhën shqipe përkthimi është *madhëruar qoftë!*

﴿مَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَعَزِيزٌ﴾

“Ata nuk e çmojnë Allahun me vlerën e vërtetë, se Allahu është, njëmend, i fortë e i plotfuqishëm.” [Haxh: 74]



Këshilla 2:

MERRNI MËSIM

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿فَاعْتَبِرُوا يَا أُولِيَ الْأَبْصَارِ﴾

“...pra, merrni përvojë, o ju të zotët e mendjes.”
[Hashr: 2]

Nuk ka gjë më të turpshme dhe më zhgënjyese në momentet kur zbresin belatë dhe sprovat sesa që njerëzit të preokupohen me përhapjen e lajmeve dhe të ndjekin zhvillimet e reja pa u ndalur që të marrim mësim nga këto ndodhi për të tashmen dhe të nesërmen.

Disa prej belave dhe sprovave janë falje gabimesh, pasi njeriu ka nevojë për besim, bindje, durim dhe stabilitet, ose mund të jenë përkujtim i kërkuar për t'u kthjelluar nga pakujdesia dhe plogështia. Disa prej tyre mund të jenë edhe dënim, i cili patjetër kërkon prej nesh që të pendohemi, të kthehemi te Zoti, të shtojmë adhurimet dhe veprat e mira.

Dijetari Ibën Bazi, Zoti e mëshiroftë, ka thënë: “Prej shenjave të zemrës së ngurtë dhe të vulosur nga të këqijat (Zoti na ruajt nga kjo gjendje!) janë kur njerëzit dëgjojnë argumente dridhëse dhe këshilla të karakterit kritikues e qortues, prej të cilave do të frikësoheshin edhe kodrat, sikur të logjikonin, e më pas vazhdojnë me tirani dhe mëkate duke qenë të luhatur në rrugën e Zotit, të përkushtuar pas pasioneve dhe epsheve pa qenë të vetëdijshëm për dënimin ose kërcënimin e mundshëm që i pret.”



Këshilla 3:

ALLAHU ËSHTË KRIJUESI

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿اللَّهُ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ﴾

“Allahu është krijues i çdo sendi.” [Zumer: 62]

Pavarësisht nga pritjet, analizat dhe shkaktarët pas përhapjes së këtij virusi të rrezikshëm, që shihet vetëm me mikroskopë precizë, larg thirrjeve dhe pasojave katastrofike negative ekonomike dhe të tjera, ky virus mbetet krijesë prej krijesave të Zotit, që i sprovon robërit e Tij për të dalë në shesh dobësia, paaftësia dhe injoranca njerëzore përballë përsosmërisë së forcës, dijes dhe fuqisë së Zotit. Ai është Allahu i Madhërishëm, që këtë krijesë të dobët e vuri përballë një krijese më të fortë se ajo, që është njeriu.

Allahu është i plotfuqishëm për t'i prishur shkaqet dhe për të gjetur krijesë pa shkak që i përngjan Isait, të birit të Merjemes, që lindi pa baba. Zoti ynë është i plotfuqishëm që t'i neutralizojë rezultatet me gjithë ekzistimin e shkaqeve, si mrekulli që nuk flet, ashtu si Zekerija a.s. edhe pse gjuha e

tij ishte e shëndoshë, por nuk pati mundësi të fliste.

A e kemi ndier madhësinë e Allahut, se Ai është krijuesi i çdo gjëje, krijuesi i shkaqeve, i shkaktrëve, i rezultateve dhe i të gjitha veprave?!

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿اللَّهُ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ وَهُوَ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ﴾

“Allahu është krijuesi i çdo sendi, Ai është i vetmi ngadhënjyes!” [Ra'd: 16]



Këshilla 4:

TI JE ROB I ALLAHUT

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿لَعَلَّهُمْ يَتَضَرَّعُونَ﴾

“...ashtu që të përulen...” [En'amë: 42]

A e kemi treguar bindjen, varfërinë, dobësinë, nevojën dhe përluljen tonë për hir të Zotit si në këto momente? Prej mësimëve madhore dhe urtësive të mrekullueshme në raste sprovash është realizimi i robërisë, nevojës dhe përluljes në të drejtën e të madhit Zot, ashtu si na e tregon në Kur'an:

﴿فَلَوْلَا إِذْ جَاءَهُمْ بَأْسُنَا تَضَرَّعُوا وَلَكِنْ قَسَتْ قُلُوبُهُمْ وَزَيَّنَ لَهُمُ الشَّيْطَانُ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ﴾

“E pse të mos përuleshin kur u erdhi atyre dënimi Ynë? Por zemrat e tyre ishin ngurosur, por edhe djalli ua hijeshoi atë që bënin.” [En’amë: 42]

Komentuesi i njohur i Kur’anit, Ibën Kethiri, për ajetin në fjalë thotë: “Ky ajet ka kuptimin: Atëherë kur ata sprovohen, i përlulen Zotit dhe kërkojnë strehim tek Ai. Pjesa: *“...por zemrat e tyre ishin ngurosur...”* do të thotë që as nuk janë zbutur e as nuk janë frikësuar. Kurse pjesa: *“...por edhe djalli ua hijeshoi atë që bënin”*, nënkupton shirkun dhe mëkatet.”

Ibën Kajimi lidhur me këtë çështje ka thënë: “Allahu nuk e sprovon njeriun që ta shkatërrojë, por e sprovon që t’i testojë durimin dhe dëgjueshmërinë e tij. Ubudije, siç quhet në gjuhën fetare dëgjueshmëria ndaj Zotit, është tre llojesh: në vë-

shtirësi, në gjëra që njeriu i urren dhe në gjëra të tjera që ai i do. Shumica e njerëzve reflektojnë në ubudije (të qenët rob i Zotit) në atë që njeriu e do, por çështja qëndron si reflekton ai (njeriu) ndaj asaj që e urren. Thjesht këtu është testi.”³



Këshilla 5:

T’I KTHEHEMI VETES

Allahu ﷻ thotë në Kur’an:

﴿فِيمَا كَسَبَتْ أَيْدِيكُمْ﴾

“...ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija)...”

[Shura: 30]

Vetëpëlqimi më i madh që shfaq njeriu është kur ndihet i sigurt se nuk e kaplon dënimi i Zotit, kur beson se është imun ndaj fatkeqësive dhe sëmundjeve. Gjëja e fundit për të cilën mendon ai është

³ El-vabil es-sajjib, f. 11.

ekzistenca e lidhjes së fortë midis fatkeqësive dhe sëmundjeve.

Në fakt, kjo është nga gjërat e ditura në Kur'an, të cilën Allahu ﷻ e ka konfirmuar në shumë ajete, si në ajetin ku u drejtohet njerëzve më të mirë pas Profetëve, shokëve të Pejgamberit Muhamed ﷺ:

﴿أَوْلَمَّا أَصَابَتْكُمْ مُصِيبَةٌ قَدْ أَصَبْتُمْ مِثْلَيْهَا قُلْتُمْ أَنَّى هَذَا ۖ قُلْ هُوَ مِنْ عِنْدِ أَنْفُسِكُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ﴾

“E kur juve u goditi një dështim (në Uhud) e që ju ia patët dhënë atë dyfish (armikut në Bedër), thatë: “Prej nga kjo?” thuaj: “Ajo është nga vetë ju!” S’ka dyshim se Allahu është i plotfuqishëm për çdo send.” [Al Imran: 165]

Sa’di përkitazi me kuptimin e këtij ajeti ka thënë: “E kur grindeni mes jush dhe mëkatoni, pasi ju mundësua të shihnit atë që donit (fitoren), kthējuni vetes suaj ta qortoni. Kini kujdes nga shkaqet e liga!”⁴

Ibën el Xhevzij në lidhje me këtë çështje shkruan: “Fatkeqësia më e madhe është vetëkënaqësia e qenies njerëzore dhe bindja ndaj njohurive të veta.

⁴ Tefsiru el-Kelami el-Mennan, f. 156.

Kjo është një sprovë që ka goditur shumë njerëz.”⁵

Ibën Abasi, kushëriri i Pejgamberit Muhamed ﷺ, lutej me këto fjalë: “O Zot, asnjë fatkeqësi nuk ka zbritur nga qielli përveçse për shkak të mëkatit dhe asgjë nuk e largon fatkeqësinë përveçse pen-dimi!”



Këshilla 6 :

ZOTI YT ËSHTË I BUTË

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿اللَّهُ لَطِيفٌ بِعِبَادِهِ﴾

“Allahu është shumë bamirës për robërit e Vet.” [Shura: 19]

Kur vijnë fatkeqësitë, të cilat përcillen me kriza, manifestohet butësia e Allahut mbi besimtarët

⁵ Sajd el-hatir, f. 470.

dhe mbikëqyrja e Tij ndaj tyre, duke i ruajtur nga çdo e keqe dhe duke ua larguar atë me të cilën përballen të tjerët. Ai i pajis me durim dhe kënaqësi ndaj sprovave. E, sikur të mos ishte butësia e Zotit, që reflekton si emër dhe cilësi, zemrat do të mbusheshin me vetmi, panik e frikë!

Duke komentuar ajetin në vijim:

﴿إِنَّ رَبِّي لَطِيفٌ لِّمَا يَشَاءُ﴾

“Zoti im me mjeshtri e butësi realizon dëshirën e Vet për çka do.” [Jusuf: 100]

Sa’di ka thënë: “Butësia e Zotit, bamirësia e Tij, shfaqet në një kohë kur njeriu nuk e pret.”



Këshilla 7:

NE KEMI NEVOJË PËR ALLAHUN

Allahu ﷻ thotë në Kur’an:

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ أَنْتُمُ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ﴾

“O njerëz, ju jeni të varfër tek Allahu.” [Fatir: 15]

Ndoshta njëra nga praktikat e adhurimeve të braktisura, veçanërisht në kohë fatkeqësish e sprovash, është shfaqja e nënshtrimit, e përruljes, e varfërisë për Allahun e Lartmadhërisëm, e qetësisë dhe e përthyerjes. Robi i Zotit është çdoherë i nënshtruar, i varfër te Zoti në çdo situatë, në begati dhe fatkeqësi, në të mirë dhe të keq, në lehtësi dhe vështirësi. Këto fatkeqësi i shpalosin këto kuptime dhe manifestojnë provimin e vërtetësisë së imanit dhe bindjes së njeriut.

Le të meditojmë për pasqyrimin e varfërisë para madhërisë së Allahut që pati Profeti Zekerija a.s. dhe për ndjenjën e dobësisë brenda vetes dhe shfaqjen e saj për Zotin, kur ai u lut që Zoti t’i dhuronte një fëmijë të mirë. Zoti ﷺ na tregoi me gjuhën e Profetit Zekerija a.s.:

﴿قَالَ رَبِّ إِنِّي وَهَنَ الْعَظْمُ مِنِّي وَاشْتَعَلَ الرَّأْسُ شَيْبًا وَمَا أَكُنُ بِدُعَائِكَ رَبِّ شَقِيًّا﴾

“Tha: “Zoti im! Vërtet, mua më janë dobësuar eshtrat, më janë përhapur thinjat në kokën ti-

me, e me lutjen time ndaj Teje o Zoti im, asnjëherë nuk kam qenë i dëshpëruar.” [Merjem: 4]

Ibën Rexhepi ka thënë: “Nuk lejohet të nënshtrohesh dhe të ndihesh i varfër përveçse përballë madhërisë së Allahut. Ai është i vetmi që meriton të adhurohet dhe ky është realiteti i adhurimit.”



Këshilla 8:

ADRESA HYJNORE

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿إِنَّمَا أَشْكُو بَثِّي وَحُزْنِي إِلَى اللَّهِ﴾

“Ai (Jakubi) tha: “Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim ia parashtroj Allahut.” [Jusuf: 86]

Prej shenjave të besimit të dobët janë ankesat e shumta drejtuar njerëzve, inatosja dhe indinjata që na kaplon, a thua se shkaqet materiale janë mekanizmi që i lëviz ato. Kush i ankohet Zotit, ka

gjetur rrugën e duhur, kurse ai që ankohet nga Zoti, e ka humbur atë rrugë. Le të kujtojmë se çfarë i ndodhi Profetit Jakub a.s., për shkak të humbjes së birit të tij, Jusufit, dhe vëllait të tij të vogël, e më pas edhe vëllait të madh të tyre. Ai humbi shikimin, e kaploi pleqëria dhe u godit nga sëmundje dhe sprova të njëpasnjëshme, por qe stabil dhe duroi. Allahu na e përshkruan këtë gjendje në Kur'anin Famëlartë:

﴿قَالَ إِنَّمَا أَشْكُو بَثِّي وَحُزْنِي إِلَى اللَّهِ وَأَعْلَمُ مِنَ اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ﴾

“Ai (Jakubi) tha: “Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim, ia parashtroj Allahut, e unë di për Allahun atë që ju nuk e dini.” [Jusuf: 86]

Ibën Kajimi ka thënë: “Ankesa drejtuar Zotit nuk do të thotë se mohon durimin e bukur, por distancimi total i njeriut nga ankesa drejtuar njerëzve për t’iu drejtuar vetëm Allahut nënkupton durim. Allahu e sprovon robin e Vet që të dëgjojë nga ai ankesën, përlulen dhe lutjet e tij. Zoti i ka qortuar ata që nuk i përlulen Atij në kohë fatkeqësish e sprovash.”⁶

⁶ Udet As-Sabirin, f. 63.

Gjithashtu ai ka thënë: “Allahu e urren atë që ankesën fillimisht ua drejton njerëzve dhe e do atë që ankesën ia drejton Atij. I është thënë dikujt: “Si i ankohesh Atij (Allahut) që nuk i fshihet asgjë?” U përgjigj: “Zoti e do nënshtrimin e robit të Tij.”



Këshilla 9:

ÇDO GJË E KA NJË FUND

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿وَكُلُّ أَمْرٍ مُّسْتَقَرٌّ﴾

“...e çdo gjë, madje, është e caktuar.” [En'amë: 42]

Prej ligjeve të Zotit te krijesat e Tij është se çdo gjë ka fillim dhe fund. Nuk ka dyshim se edhe kjo pandemi do të zhdukët, do të kalojë. Kjo mbjell qetësi, rehati dhe gëzim në zemrat e besimtarëve.

Ky është përgëzimi i përfundimit të mirë për besimtarët dhe fitore kundër kësaj fatkeqësie, me lejen e Allahut.

Allahu ﷻ thotë:

﴿لِكُلِّ نَبِيٍّ مُّسْتَقَرٌّ﴾

“çdo lajm e ka kohën e vet, të caktuar.” [El-En’amë: 67]

Sa’di në tefsirin e tij thotë: *“Pra, kohën kur do të ekzistojë lajmi dhe ajo kohë për të as nuk shtohet e as pakësohet.”*

Ky është një realitet i ngulitur, që Kur’ani e konfirmon në disa vende, si në ajetin:

﴿لِكُلِّ أَجَلٍ كِتَابٌ﴾

“Për secilin afat ekziston evidencë e caktuar.”
[Ra’d: 38]

Në tefsirin Fet’h el Bejan, 7/68, në komentimin e ajetit thuhet: “Për çdo gjë Allahu ka shkruar afat të caktuar, kohë të ditur. Qëllimi me fjalën “afat i caktuar” është koha e ekzistimit, sepse çdo gjë e gjallë ka kohën e vet të caktuar kur do të jetojë e

ekzistojë, as nuk i shtohet ky afat, as nuk i pakësohet”.



Këshilla 10:

DURIMI I MIRË

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿فَصَبْرٌ جَمِيلٌ﴾

“Durim i mirë (pa ankesë).” [Jusuf: 18]

Gjëja më madhështore që e ndihmon njeriun për t’i tejkaluar sprovat dhe fatkeqësitë është pajisja me durim dhe forcë vullneti, sepse ky është morali i të mëdhenjve. Ekzistojnë faktorë psikikë që e shtyjnë njeriun drejt frikës, të cilët kanë fuqi varësisht nga fuqia e të sprovuarit, dhe faktorë shpirtërorë që e shtyjnë njeriun drejt durimit dhe të qenët i kënaqur me caktimin e Zotit. Kur njeriu kërkon ndihmë nga Zoti për durim, me të vërtetë

faktorët shpirtërorë do të triumfojnë, që ai të pajiset me durim të bukur.

Durimi i mirë është ai durim apo sabër që nuk shoqërohet me indinjatë ndaj caktimeve të Zotit, as me kundërshtim ndaj vendimeve hyjnore, as me shkëputje nga adhurimi i Allahut, as me ankesë te dikush tjetër pos Zotit, as me zemërim, as me pikëllim, as me lodhje kur vijnë fatkeqësitë. Allahu thotë duke këshilluar krijesën më të mirë, Pejgamberin Muhamed ﷺ:

﴿فَاصْبِرْ صَبْرًا جَمِيلًا﴾

“Ti, pra, duro me një durim të mirë (pa ankesë).” [Mearixh: 5]

Kurse për Pejgamberin Jakub, paqja qoftë mbi të, pasi e kishin kapluar sprovat, Allahu ﷻ na tregon në Kur’an se ai u shpreh:

﴿فَصَبِرْ جَمِيلًا ۖ وَاللَّهُ الْمُسْتَعَانُ عَلَىٰ مَا تَصِفُونَ﴾

“Halli im është durim i mirë (pa ankesë). Allahu është nga i cili kërkohet ndihmë për këtë që përshkruani ju.” [Jusuf: 18]

Allahu ju mëshiroftë, dijeni se ai që e ka humbur këtë shans, ka humbur shumëfish më tepër edhe mirësitë që përcjellin durimin, si kënaqësia, gëzimi dhe shpërblimi. Le të meditojmë për atë që thotë Ibën Haxheri: *“Durimi përballë sprovave të dynjasë trashëgon xhenetin”*.



Këshilla 11:

OPTIMIZMI ËSHTË BESIM

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿وَلَا تَيْأَسُوا مِنْ رَوْحِ اللَّهِ﴾

“E mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut.” [Jusuf: 87]

Obligohemi në kohë fatkeqësish që krahas duriimit mos të humbim shpresën dhe angazhimin me vetveten, sepse kjo lind zellin dhe na jep bindje

ndaj Zotit. Duhet ta njohim rëndësinë e optimizmit, të largimit nga pikëllimi, dëshpërimi dhe pesimizmi, e kjo të jetë e vazhdueshme sepse një vështirësi nuk i mund dy lehtësime. Allahu ﷻ thotë:

﴿ فَإِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا ﴿٥﴾ إِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا ﴾

“E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi.”
[Sherh: 5-6]

Le të meditojmë se si Jakubi a.s., ka bashkuar durimin e mirë pa ankesa me shpresën dhe optimizmin në një kohë të vështirë duke filluar të bashkëveprojë me logjikë për gjendjen dhe jo problemin dhe duke vepruar shkaqet e mundshme. Kur’ani na e përshkruan këtë realitet:

﴿ وَقَالَ يَا بَنِيَّ لَا تَدْخُلُوا مِنْ بَابٍ وَاحِدٍ وَاَدْخُلُوا مِنْ أَبْوَابٍ مُتَفَرِّقَةٍ ﴾

“Por ai (Jakubi) tha: “O bijtë e mi, mos hyni (në Egjipt) për një derë, po hyni nëpër dyer të ndryshme.” [Jusuf: 67]

Megjithatë i këshilloi dhe i ktheu bijtë e vet te parimi madhor, që është besimi në kader, mbështetja te Zoti dhe kthimi tek Ai.

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿ وَمَا أَعْنِي عَنْكُمْ مِنَ اللَّهِ مِنْ شَيْءٍ ۚ إِنَّ الْحَكْمَ إِلَّا لِلَّهِ ۗ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ ۗ وَعَلَيْهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُتَوَكِّلُونَ ﴾

“Unë nuk mund të largoj prej jush asnjë send nga caktimi i Allahut, vendimi nuk është i tjetërkujt vetëm i Allahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm Atij le t'i mbështeten ata që besuan.” [Jusuf: 67]

Me vazhdimin e fatkeqësisë Jakubi a.s. mbeti optimist, jetoi me shpresë dhe tha:

﴿ يَا بَنِي إِدْهَبُوا فَتَحَسَّسُوا مِنْ يُوسُفَ وَأَخِيهِ وَلَا تَبْأَسُوا مِنْ رَوْحِ اللَّهِ ۗ إِنَّهُ لَا يَبْأَسُ مِنْ رَوْحِ اللَّهِ إِلَّا الْقَوْمُ الْكَافِرُونَ ﴾

“(Jakubi u tha të bijve të vet) O bijtë e mi, shkoni dhe hulumtoni (në Egjipt) për Jusufin dhe vëllain e tij, e mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut, pse vetëm populli jobesimtar e humb shpresën në Allahun.” [Jusuf: 87]

Pejgamberi ynë, Muhamedi ﷺ, ua mësonte shokëve të tij këto kuptime madhore dhe i mbillte në shpirtrat e tyre. Siç shënojnë Buhariu dhe Muslimi, i Dërguari Muhamed ﷺ ka thënë: *“Nuk ka sëmundje ngjitëse dhe as nuk ka ‘zog ham’ (që paralajmëron të keqen). Më pëlqen optimizmi.”* I thënë: *“Çfarë është optimizmi?”* Tha: *“Fjala e mirë.”*



Këshilla 12:

BINDJA NË ZOT

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿وَكَانُوا بِآيَاتِنَا يُوقِنُونَ﴾

“Dhe ndaj argumenteve Tona ishin të bindur.”

[Sexhde: 24]

Besimi në Allah, mbështetja dhe autorizimi i çështjeve tona tek Ai janë rrugët më të mira për tejkalimin e fatkeqësive dhe sfidave, ashtu si bin-

dja (jekin) që ndihma e Allahut do të vijë pa dyshim dhe se pas vështirësisë vjen lehtësimi janë nga shkaqet më të qarta të lehtësimit të sprovave. Kur bindja në Zot forcohet, njeriu është më afër durimit, kënaqësisë dhe dorëzimit para Zotit. Profeti Muhamed ﷺ sa herë që ngrihej nga mexhli-si, lutej me fjalët: *“Dhe na jep atë bindje, e cila na i lehtëson fatkeqësitë e kësaj jete.”*⁷

Kur sprova u rëndohet besimtarëve, bindja e tyre te Zoti forcohet, nuk dobësohet, sepse kjo kategori nuk e njih dëshpërimin. Njerëzit më të durueshëm në sprova dhe fatkeqësi kanë bindjen më të madhe, kurse ata që më së shumti janë të indinjuar e të hidhëruar në sprova kanë më pak bindje në Zot. Zemra e besimtarit është e bindur si një kështjellë e fortë që nuk e tronditin furtunat e fatkeqësive, madje veç ia shtojnë fuqinë.

Ibën Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur me të, siç përmendet në librin “El-Jekin” të Ibn Ebi Dunjasë, në faqen 42, ka thënë: “Me të vërtetë freskimi dhe shpëtimi janë në bindje dhe kënaqësi, ndërsa brenga dhe mërzia në dyshim dhe hidhërim”. Në “Esh-Shukru”, po kështu të Ibn Ebi Dunja, në fa-

⁷ Shënon Tirmidhiu, shkalla e hadithit është hasen.

qen 24, shënohet se ai ka thënë: “Bindja në Zot (jekini) dhe imani janë së bashku”.

Sufjan eth-Thevrij në “Hiljet El-Evlia”, 7/9, ka thënë: “*Bindje (jekin) është të mos e akuzosh Zotin tënd për çdo gjë që të godet dhe të sprovon*”.

Ibën Kajimi në “Medarixh Es-Salikin”, 2/374, ka thënë: “*Bindja në Zot (jekin) është shpirti i veprave të zemrave, që janë shpirtat e veprave të gjymtyrëve, ajo është realiteti i sinqeritetit.*”



Këshilla 13:

BËHUNI SYÇELË

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿خُذُوا حِذْرَكُمْ﴾

“Bëhuni syçelë.” [Nisa: 71]

Veprimi i shkaqeve materiale legjitime të mundshme është prej ligjeve kozmologjike. Kjo gjithashtu ishte veçori e të Dërguarve, e të devotshmëve dhe bazë e realizimit të adhurimit, e plotësimit të bindjes në Zot.

Allahu i Lartësuar na është drejtuar në shumë aje-te kur'anore që t'i veprojmë shkaqet si në rastin e Merjemes, nënës së Isait alejhi selam, kur Zoti e urdhëroi që ta shkundte trupin e palmës që të binin hurmat, edhe pse gjendja e saj ia pamundësonte një gjë të tillë për shkak se ishte në momentet e lindjes së Isait, e dobët për ta bërë një gjë të tillë, megjithatë ky hap ishte veprim i shkaqeve të duhura për momentin e duhur (që të binin frutat e hurmave, të cilat ishin ushqim forcues për të).

Realiteti i mbështetjes te Zoti (tevekul) është mbështetja e zemrës tek Allahu me kryerjen e shkaqeve. Mbështetja tek Allahu dhe kundërshtimi i veprimit të shkaqeve është diskreditim në shëritin islam dhe mangësi logjike, ndërsa e kundrat e saj, veprimi i shkaqeve dhe anashkalimi i mbështetjes së zemrës tek Allahu është mangësi e teuhidit (të adhuruarit vetëm Allahun) dhe shirk (rivalitet) në shkaqe.

Ibën Kajimi, Allahu e mëshiroftë, në “Medarixh Salikin”, 2/120, ka thënë: “Mbështetja te Zoti është nga shkaqet madhore që përmes saj realizohen kërkesat e mira dhe largohen të këqijat. Ai që mohon shkaqet nuk e ka kuptuar mbështetjen në Zot (nuk është në rrugën e duhur), pasi prej plotësimit të mbështetjes (tevekulit) është mospërujja totale ndaj shkaqeve dhe ndërprerja e zemrës me mbështetje në Zotin”.

Këtë kuptim preciz e ka konfirmuar edhe dijetari islam Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, dhe e ka përcjellë prej shumë dijetarëve në “Tufetu El-Irakije”, faqe 52, ku thotë: “Të kapesh për shkaqe është shirk në teuhid, anulimi i tyre do të ishte mangësi në logjikë dhe kundërshtimi total i tyre është diskreditim i sheriatit. Por, mbështetja është e besueshme kur plotëson tre komponentë; teuhidin, logjikën dhe sheriatin”.



Këshilla 14:

ÇFARË HALLI KE

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿ وَاللَّهُ خَيْرٌ وَأَبْقَى ﴾

“Allahu është më i miri (në të shpërblyer) dhe më i përjetshmi (në të dënuar)!” [Taha: 30]

Sot muslimanët janë të ngjashëm me të tjerët, të gatshëm dhe vigjilentë si individë, shoqëri, shtete, institucione përmes rrjeteve sociale dhe programeve televizive me masa preventive dhe fortifikime të fuqishme përballë këtij virusi (Corona), i cili i tronditi të gjithë, edhe pse kjo është çështje instinkti, natyrshmëri që ndodh sepse ruajtja e jetës është nga objektivat e sheriatit dhe domosdoshmëri madhore.

Por, nga ana tjetër, çuditësh kur sheh ftohtësi dhe ngurtësi, indiferencë dhe mungesë vigjilence për fatkeqësinë e fesë në nivel individ, umeti, që kërcënojnë besimin, parimet, moralin, shenjtërinë, madje edhe ekzistencën tonë.

Pejgamberi ﷺ thoshte në lutjen e tij: “Mos na sprovo në fenë tonë, mos e bëj dynjanë brengën tonë më të madhe dhe as kufirin tonë të dijes”⁸. Fatkeqësia në fe është fundi i humbjes, i cili nuk është fitimprurës. Të kuptuarit e drejtë të fesë është në atë se çdo sprovë përveç provës së fesë është e tejkalueshme.

Realiteti i hidhur qëndron në atë se çdo fatkeqësi që lidhet me këtë botë ngjall zgjim dhe vigjilencë për të, ndërsa fatkeqësitë fetare sikur të jenë një ujë i ftohtë, që nuk ngjallin interesim. Junus bin Ubejdi në “El-Hilje”, 3/19, ka thënë: “Çfarë është puna me mua, më humbet një pulë dhe mërzhitem, më humb një namaz dhe nuk mërzhitem?!”

Hatim el Esem në “Elihja”, 1/149, ka thënë: “Më ka ikur namazi një herë dhe nuk më ka ngushëlluar përveç Ebu Is’haku el Buhariu. E, sikur të më vdiste im bir, do të më shprehnin ngushëllime më shumë se dhjetë mijë veta sepse fatkeqësia e fesë është bërë sot më e lehtë se fatkeqësia e dynjasë”.

⁸ Mos na bëj nga ata që mendojmë vetëm për këtë botë, por na bëj edhe nga ata që mendojnë edhe për botën tjetër.

Betohemi në Allahun se është fatkeqësi e madhe që të përdhoset nderi i muslimanëve në çdo vend, sot nuk lëviz askush në këtë drejtim, që të ngjallë interesim apo vigjilencë në këto çështje. Kush i jep përparësi dynjasë para fesë, vetëm se është sprovuar me një fatkeqësi të madhe. Allahu ﷻ thotë:

﴿فَأَنهَا لَا تَعْمَى الْأَبْصَارُ وَلَكِن تَعْمَى الْقُلُوبُ الَّتِي فِي الصُّدُورِ﴾

“Pse në të vërtetë sytë nuk verbërohen, por verbërohen zemrat në kraharorë.” (Haxh: 46)



Këshilla 15:

NËSE DO ZOTI, DO BËHET MIRË

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿وَعَسَىٰ أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ﴾

“Mund ta urreni një gjë, por ajo është e mirë për ju.” [Bekare: 216]

Ndoshta njeriu demoralizohet ose e godasin bren-gat, hallet, mërzia nga caktimet e hidhura dhe fat-keqësitë e dhimbshme dhe sëmundjet shkatërru-ese, sidomos kur vijnë befaz, pa paralajmërim, në një kohë ku mbizotërojnë siguria dhe qetësia. Por, besimtari është i bindur në kaderin e Allahut, ur-tësinë, mëshirën, butësinë e Tij, e di që kjo është pastrim për zemrat dhe tërheqje e vërejtjes nga pa-kujdesia për ta shndërruar sprovën në mirësi dhe belanë në dhuratë.

Nëse ndalemi dhe shikojmë dobitë, frytet, përfi-timet që kthehen te njeriu në fenë, imanin, ze-mrën, sjelljen dhe të gjitha çështjet e tij gjatë vësh-tirësive e sprovave që e kanë goditur, ai bindet se ajo që ka përzgjedhur Allahu për të në atë që ai e urren është më e mirë se ajo që ka përzgjedhur ai për vetveten nga ajo që dëshiron.

Profeti Muhamed ﷺ, ashtu si shënon Muslimi në sahihun e vet, ka thënë: *“Është e çuditshme puna e besimtarit. E gjithë jeta e tij është dobi. Nëse atij i vjen një e mirë, ai falënderon Zotin dhe merr shpër-blim për këtë gjë. Nëse atij i bie një fatkeqësi, ai duron për hir të Zotit dhe përsëri shpërblehet për këtë gjë. E kjo gjë ndodh vetëm me besimtarin.”*

Hatib el Bagdadi në librin *Tarih*, 14/298, ka përmendur: “Është sëmure Fadël bin Sehl Dhu Rejastin me një sëmundje në Horasan e më pas u shërua dhe shkuan njerëzit për ta vizituar. Ata biseduan dhe ai iu drejtua duke u thënë: “Në sëmundje ka begati që njerëzit e mençur duhet t’i dinë: pastrim për mëkatet, shpërblim për durimin, zgjim nga pakujdesia, përkujtim të begatisë në kohë të shëndetit, ftesë për pendim dhe inkurajim për lëmoshë”.



Këshilla 16:

QIELLI ËSHTË AFËR

Allahu ﷻ thotë në Kur’an:

﴿ فَإِنِّي قَرِيبٌ ﴾

“...Unë jam afër...” [Bekare: 186]

Lutjes së sinqertë i hapen dyert e qiellit, i largohen pengesat, i shkurtohen distancat dhe afrohet afër Mëshirëbërësit.

﴿وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ ۖ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ﴾

“Kur besimtarët e Mi të pyesin për Mua, (thua-ju): Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit.” [Bekare: 186]

Hasen el-Basriu ka thënë: “Çelësi i qiellit është lutja”.

Enes bin Maliku radijaAllahu anhu ka thënë: “*Me të vërtetë Allahu e sprovon zemrën me lutje.*”

Uehb bin Munbihin ka thënë: “*Bie sprovë e del lutja.*”

Buhariu ka shkruar kapitullin “*Lutja e cila largon epideminë dhe dhembjen*”. Gjithashtu Nesaiu ka shkruar një kapitull: “*Lutja e largon epideminë*”.

Lutja është një adhurim madhështor, ashtu siç është saktësuar nga Pejgamberi ﷺ, e cila më së shumti ka dobi dhe ndikim kur del nga sinqeriteti, nga reflektimi i varfërisë njerëzore karshi madhërisë hyjnore, nga përrulja, nga mendimi i mirë për

Allahun dhe bindja për përgjigjen e lutjes. E gjithë kjo duhet të jetë me vazhdimësi dhe pa ngutje. Ibën Kajimi thotë: *“Ilaçi më i mirë është këmbëngulësia në lutje”*.



Këshilla 17:

A IA VLEN BARRA QIRANË

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿ إِنَّمَا هَذِهِ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا مَتَاعٌ ﴾

“...me të vërtetë jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi e përkohshme...” [Gafir: 39]

Meditoni për këtë virus kaq të vogël, një krijesë e dobët që nuk shihet me sy, e cila u prish njerëzve begatitë, kënaqësitë, sigurinë dhe stabilitetin e jetës. Një botë që kthehet kundër jush, ju tradhton, ndryshon, asnjëherë nuk rri e njëjtë. A i ka hije njeriut të mençur, e të mos flasim për besimtarin,

që ta marrë për atdhe dhe vendbanim, të rrijë i qetë e të luftojë për të, të garojë për të?!

Kush nuk merr mësim nga realiteti i kësaj bote me dëshirën e tij, do ta mësojnë caktimet, sfidat e fatkeqësitë që ta marrë atë mësim me detyrim. Kjo botë nuk i jep mundësi të pasurit çdoherë të jetë i pasur, të shëndetshmit çdoherë të jetë i shëndetshëm sepse kjo botë është e neveritshme, e vdekshme, e pavlerë.

Allahu ﷻ thotë:

﴿ أَفَرَأَيْتَ إِنْ مَتَّعْنَاهُمْ سِنِينَ ﴿٢٠٥﴾ ثُمَّ جَاءَهُمْ مَا كَانُوا يُوعَدُونَ ﴿٢٠٦﴾ مَا أَغْنَىٰ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يُمْتَعُونَ ﴾

“E, çka mendon ti, nëse Ne u japim atyre, që të kënaqen disa vite, e pastaj t’i godasë ata ajo që u është premtuar (dënimi), nuk do t’u vlejë asgjë atyre ajo me të cilën janë kënaqur.” [Shuara: 205-207]

Të ndalemi pak me kujdes e të shohim se çfarë tha ai që nuk flet nga hamendja për realitetin e kësaj bote. Muhamedi ﷺ, siç përmendet në “Sahih Muslim”, ka thënë: “*Betohem në Allahun se dynjaja përballë ahiretit nuk është vetëm se si shem-*

*bulli i atij që e fut gishtin tregues në det dhe shikon
çfarë po merr.*”

Më e madhe se kjo është fjala e Allahut:

﴿ وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا مَتَاعُ الْغُرُورِ ﴾

**“Jeta në këtë botë është vetëm një kënaqësi e
rrejshme.”** [Hadid: 20]

I është thënë Hakimit: -Si është shembulli i kësaj
bote? Tha: “Ajo është më e paktë sesa të merret
për shembull”.

Prej porosive të Mesihut për pasuesit e vet ishte:
“Kaloni nëpër këtë dynja e e mos jetoni në të”.
Siç përshkruhet edhe në librin “Zuhd” të Ahme-
dit, faqe 53, Mesihu shpesh thoshte: “Me të drejtë
ju them juve: Ai që më së shumti e do këtë botë,
ai më së shumti do të ketë dhembje në fatkeqësi”.



Këshilla 18:

NGA PUNA NDALEMI VETËM KUR TË HYJMË NË XHENET

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿ لَا يَبْغُونَ عَنْهَا حَوْلًا ﴾

“...dhe nuk lypin ta ndërrojnë me asgjë tjetër...” [Kehf: 104]

Njeriu në këtë botë jeton mes së mirës dhe së keqes, mes begatave dhe fatkeqësive, mes shëndetit dhe sëmundjes... Ajo që ia lehtëson besimtarit fatkeqësitë e dhembjet dhe ia pakëson mërzinë dhe sëmundjet është bindja se në xhenet nuk ka pakënaqësi, të vogla apo të mëdha. Xheneti është vendi i përjetësisë, i paqes, i begatave të përjetshme që nuk përfundojnë. Në të ka lumturi, gëzim, dashuri.

Ajo që më së shumti ua prish begatitë njerëzve në këtë dynja është vdekja dhe mërzia, të cilat nuk gjenden në xhenet. Allahu thotë për kënaqësitë e banorëve të xhenetit:

﴿ خَالِدِينَ فِيهَا لَا يَبْغُونَ عَنْهَا حَوْلًا ﴾

“Aty do të qëndrojnë përgjithmonë dhe nuk lypin ta ndërrojnë me asgjë tjetër.” [Kehf: 104]

Përjetësimi në xhenet i shpëton, vdekja nuk ka mundësi t’ua prishë kënaqësinë në të, nuk i kaplon mërzia e as që kanë nevojë për ndonjë ndryshim sepse nuk shohin kënaqësi më të madhe se ajo që kanë. Mutraf bin Sheuhejri ka thënë: “Me të vërtetë vdekja njerëzve ua prish kënaqësitë e kësaj bote. Kërkoni kënaqësi që nuk njeh vdekje.”

Prej këshillave që na jep kjo provë (virusi Corona) është që i mençuri të durojë për të arritur rehati të përjetshme që nuk përfundon, të jetë aktiv që nefs i tij të përmallohet për botën tjetër, xhenetin.



Këshilla 19:

KI FRIKË ZOTIN

Allahu ﷻ thotë në Kur’an:

﴿وَحَافُونَ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ﴾

“Frikësohuni mua, nëse jeni besimtarë!” [Al Im-ran: 175]

Nuk ka dyshim se Covid-19 është prej fakteve kozmologjike me të cilat Allahu i frikëson robërit e Vet për t’i këshilluar dhe marrë mësim që të ngjallin “ubudijen e frikërespektit” në raport me Allahun dhe faktet e Tij në këtë kozmos.

Allahu ﷻ thotë:

﴿وَمَا نُرْسِلُ بِالآيَاتِ إِلَّا تَخْوِيفًا﴾

“Ne dërgojmë fakte vetëm për t’i frikësuar njerëzit.” (Isra: 59)

Katade në tefsirin e Ibën Kethirit, vëllimi V, faqe 91, thotë: “Allahu i frikëson njerëzit me atë që do nga faktet (argumentet) e Tij, ndoshta që të marrin mësim, të përkujtojnë e të kthehen (në rrugën e Zotit)”.

Ngjallja e “ubudijes së frikërespektit” nga argumentet e Allahut është nga udhëzimet profetike. Enesi në “Sahih Buhari” ka thënë: “Kur era e fortë godiste, kjo vërehej në fytyrën e Pejgamberit Muhamed ﷺ.”

Kjo frikë e kaplonte të Dërguarin e Zotit, edhe pse atij i ishin falur mëkatet! E, si është gjendja me ne që jemi neglizhues?! Më e çuditshme është gjendja e disa muslimanëve, të cilët me gjithë përhapjen e këtij virusi janë të preokupuar me anekdota, tallje, shaka, qeshje e lojëra. Hutohen nga blerja dhe grumbullimi i ushqimeve duke qenë neglizhues, injorojnë urtësitë hyjnore në sprovat dhe fatkeqësitë me të cilat Zoti i sprovon robërit e Tij.

Ka shumë rëndësi realizimi i “ubudijes së frikërespektit” nga argumentet dhe frikërespekti nga Zoti i tokës dhe i qiejve. Pejgamberi Muhamed ﷺ shpesh lutej me këtë lutje: “Zoti ynë, na jep, na begato me frikë aq sa frika të na pengojë nga mëkatet!”

E lusim Zotin që butësia e Tij t’i kaplojë robërit e Tij, që të largojë prej nesh çdo brengë e telash dhe ta largojë këtë virus! Amin!



Këshilla 20:

KOHA ËSHTË VETË JETA

Allahu ﷻ thotë në Kur'an:

﴿ فَإِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ ﴾

“E kur ta kryesh (obligimin), atëbotë mundohu me adhurim (ndaj Allahut).” [Sherh: 7]

Koha është materia e jetës, kapitali i pasurisë së muslimanit në këtë jetë. Koha është më me vlerë se pasuria, më e shtrenjtë se çdo çmim. Për shkak të rëndësisë së saj Allahu është betuar për kohën. Buhariu shënon nga Pejgamberi ﷺ, se ka thënë: *“Në dy gjëra janë të mashtruar shumica e njerëzve: shëndeti dhe koha e lirë”*.

I mençur, syçelë është ai që çdo herë e shfrytëzon kohën e tij dhe kjo bëhet edhe më e rëndësishme në kohë krizash, sprovash, sepse ato e afrojnë njeriun te Zoti dhe nuk e humb kohën kot. Është thënë se “kush e shet të vlefshmen pa çmim, do ta blejë të lirën me çmimin më të shtrenjtë”.

Ibën Kajimi në “El-Fauaid”, faqe 31, ka thënë: “Humbja e kohës është më e rëndë se vdekja sepse humbja e kohës të ndan nga Zoti, ndërsa vdekja të ndan nga jeta e kësaj bote dhe banorët e saj.”

Komentatori i Kur’anit, Shinkiti, në “Edvau el Bejan”, vëllimi VIII, faqe 579, në lidhje me ajetin kur’anor:

“E kur ta kryesh (obligimin), atë botë mundohu me adhurim (ndaj Allahut)”, [Sherh: 7], thotë se “kjo është zgjidhje e problemit të kohës së lirë që i ka preokupuar njerëzit dhe që nuk ka lënë hapësirë për muslimanin që të ketë kohë të lirë. Muslimani ose është i angazhuar me punë për këtë botë ose me punë për botën tjetër”.

Abdullah bin Mesudi ka thënë: “Unë e urrej njeriun që e shoh duke qëndruar i paangazhuar në asgjë, qoftë nga punët e kësaj jete apo të botës tjetër”.

Të parët tanë na kanë dhënë modele konkrete se si i kanë shfrytëzuar krizat për të bërë vepra të mira.

- 1) Serahsij ka shkruar librin e tij *“El Mabsut”*⁹ me pesëmbëdhjetë vëllime duke ua diktuar nxënësve të tij teksa ishte i burgosur.
- 2) Ibën Ethiri ka shkruar librat *“Xhami el Usul”* dhe *“En Nihaje fi Garibil el Hadith”* kur ishte i paralizuar.
- 3) Ibën Tejmije pjesën më të madhe të librit *“Fetava”* e shkroi kur ishte i burgosur.



⁹ “El Mabsut” është libër bazë në medhhebin hanefij.

MBUROJAT PARANDALUESE SHERIATIKE PREJ SËMUNDJEVE ABSTRAKTE DHE KONKRETE

Në kohën e përshpejtimit të përhapjes së virusit Corona (sëmundja Covid-19), me zgjerimin e zonës gjeografike dhe me përshkallëzimin e valëve të frikës dhe panikut mes njerëzve nga kjo sëmundje infektive, e kemi më se të domosdoshme të rikujtojmë mburojat preventive sheriatike nga sëmundjet abstrakte dhe konkrete.

1. Ilaçi dhe mburoja e parë dhe më e rëndësishmja në kohë krizash dhe fatkeqësish është kthimi te Zoti. Para se të mendojmë për shkaqet materiale dhe zgjidhjet konkrete e të prekshme, le të kërkojmë strehim, ndihmë e mbrojtje tek Allahu i Madhëruar, që të na mbrojë nga e keqja. Jusufi a.s., kur u josh nga zonja e pallatit, tha:

﴿ قَالَ مَعَاذَ اللَّهِ ﴾

“Allahu më ruajt!” [Jusuf: 23]

Merjemja alejha selam, kur i erdhi Xhibrili alejhi selam dhe iu personifikua në formë njeriu, i tha prerazi:

﴿ قَالَتْ إِنِّي أَعُوذُ بِالرَّحْمَنِ مِنْكَ ﴾

“Unë i mbështetem të Gjithëmëshirshmit prej teje.” [Merjem: 18]

2. Shpeshtimi i duasë, përgjërimi, përulja dhe ndjenja e varfërisë karshi Zotit për ta larguar sprovën. Lutja është madhështore, ajo ka pozitë dhe vend të lartë, sepse me të largohet fatkeqësia, ajo është arma e besimtarëve, kalaja e fortifikuar. Duke qenë se sëmundja është caktim hyjnor, lutja luan rol të pazëvendësueshëm, siç është konfirmuar nga Profeti Muhammed ﷺ në transmetimin e Tirmidhiut me zinxhirë të mirë: *“Nuk e ndryshon kadanë (caktimin e Zotit) asgjë pos duasë.”*

Për pranimin e duasë duhet të realizohen shkaqet, kushtet dhe kriteret plotësuese, siç është ushqimi, veshmbathja, bindja dhe përzgjedhja e kohëve kur ajo pranohet. Profeti Muhamed ﷺ ka përmendur një lidhje tejet të çuditshme mes duasë dhe belasë, siç thuhet në “Sahih el Xhami”, nr. 7739: *“Duaaja i bën dobi asaj që ka ndodhur dhe që nuk ka ndodhur. Kur zbret belaja, e pengon duaaja dhe shtyhen mes vete deri në Ditën e Kiametit.”*

3. Shoqërimi me Kur’anin Fisnik dhe kërkimi i shërimit me të. Kur’ani është ilaç për çdo sëm-

undje abstrakte e konkrete, siç thuhet në Kur'an:

﴿وَنُنَزِّلُ مِنَ الْقُرْآنِ مَا هُوَ شِفَاءٌ وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ﴾

“Ne të shpallim Kur'anin, që është shërim për besimtarët.” [Isra: 82]

Kur niveli i bindjes dhe i sinqeritetit është më i lartë, rritet edhe mundësia e shërimit, me lejen e Zotit. Allahu ﷻ thotë:

﴿قُلْ هُوَ لِلَّذِينَ آمَنُوا هُدًى وَشِفَاءٌ﴾

“Thuaj: “Ai është për besimtarët udhëzues e shërues.” [Fusilet: 44]

Ibën Kajimi ka shkruar në “Zad el Mead”, faqe 266: “Kur'ani është shërim i plotë prej të gjitha sëmundjeve të zemrës e të trupit, prej sëmundjeve të dynjasë dhe të ahiretit. Jo çdo njeri ka sukses në shërimin me Kur'an. Kur i sëmuri e përdor mirë këtë ilaç në sëmundjen e tij me sinqeritet e besim, duke e pranuar me bindje të prerë dhe plotësim të kushteve në të njëjtën kohë, nuk mund t'i rezistojë asnjë sëmundje.”

Kur'ani në tërësi është shërim, por disa kaptina dhe ajete janë më të forta dhe më shëruese se

kaptinat dhe ajetet e tjera, si kaptina Fatiha, kaptina Felek, Nas, ajeti i Kursisë.

Ibën Kajimi në “El-Xhevab el Kafij”, faqe 9, ka thënë: “Sikur njeriu të mjekohej me Fatiha, do të shihte ndikim të çuditshëm në shërim. Kam qëndruar në Mekë i sëmurë për një kohë, gjatë së cilës kam pasur nevojë për ilaçe, por nuk kam gjetur as mjek as ilaçe. E kam mjekuar veten me Fatiha dhe kam parë se kishte ndikim të çuditshëm. Ua kam propozuar njerëzve që ankoheshin nga dhembjet dhe shumica prej tyre janë shëruar shpejt.”

4. Falja e pesë kohëve të namazit në kohën e vet, sidomos namazi i sabahut në kohën e vet me xhemat. Pejgamberi ﷺ, siç shënon Muslimi, ka thënë: “*Kush e fal namazin e sabahut, ai është nën mbrojtjen e Allahut*”. Në një transmetim tjetër (Sahihu Tergib, Albanij, nr. 461) ka thënë: “*Kush e fal sabahun me xhemat, ai është nën mbrojtjen e Allahut.*”

Kuptimi i fjalës “dhimmetullah”, “nën mbrojtjen e Allahut”, që ka ardhur në hadith, ka disa kuptime. Imam Neveviu thotë se ka kuptimin: garanci, siguri, ruajtje, ruajtje nga fat-

keqësitë, gabimet dhe mëkatet. Mubare el Furij thotë: “Në garancinë e Allahut, siguri në dynja dhe ahiret”.

5. Duaja e veçantë e përmendur në Sunetin autentik. Kur njeriu sheh ndonjë të sëmurë apo të sprovuar, le të thotë: *“Falënderimi i takon Allahut që na ka dhuruar shëndet në atë që të ka sprovuar dhe më ka nderuar nga shumë krijesat e Tij”*.

Ky është udhëzimi madhështor profetik për atë që sheh ndonjë të sëmurë ose të sprovuar në fenë ose në jetën e tij. Ai duhet ta thotë këtë dua me bindje dhe besim për ndikimin e saj, se Allahu do ta shërojë!

Vërejtje: Ndonjëherë hasim që njerëzit bëjnë shaka, tallen ose ushtrojnë bullizëm ndaj njerëzve të sëmurë apo me aftësi të kufizuara, por kjo nuk lejohet fetarisht, është e ndaluar dhe në kundërshtim me fenë tonë.

6. Leximi i kaptinave Ihlas, Felek, Nas. Këto sure, të cilat lexohen tri herë në mëngjes dhe mbremje, të mbrojnë nga çdo e keqe. Shënojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, ndërsa Albani e ka bërë të mirë hadithin, se Pejgamberi ﷺ ka

thënë: “*Kulhuva Allahu ehad, muauidhetejn (Fek-Nas) kur të vijë nata dhe dita tri herë, të mjaftojnë për çdo gjë.*” Taberiu thotë: “Të mbr-ojnë nga çdo e keqe.”

7. Leximi i lutjes profetike që thuhet tri herë në mëngjes dhe në mbrëmje. Kjo lutje është si vijon: ***Bismil-lahil-ledhi la jedurr-rru me’a-ismihi shej’un fil-erdi ve la fis-semai ve huves-semiul- alim.***

“*Me emrin e Allahut, pranë emrit të të Cilit nuk bën dëm asgjë në tokë e as në qiell, Ai që dëgjon shumë dhe di çdo send.*”

E kanë shënuar Tirmidhiu (5/465) dhe Ebu Davudi (4/323), kurse Ibën Bazi në “*Tuhfetul-Ahjar*”, faqe 39, senedin e këtij hadithi e ka bërë të mirë (hasen).

Tirmidhiu ka shkruar në sunenin e tij se “Kush e thotë këtë lutje në mëngjes dhe mbrëmje çdo ditë, nuk i bën dëm asgjë”.

Kurtubiu thotë: “Ky është lajm i vërtetë, argument praktik. Unë nga koha që e kam dëgjuar, kam punuar me të dhe nuk më ka goditur asgjë, përveç atij rasti që e kam lënë dhe më ka

pickuar një akrep në Medinë natën. Kisha harruar ta thosha këtë lutje.”

8. Prej mburojave profetike që ka shënuar Ebu Davudi në sunenin e tij, të cilën e ka saktësuar Albani, është se Profeti Muhamed ﷺ ka thënë: *“Zot, kërkoj mbrojtjen Tënde nga lebra, çmenduria dhe nga çdo sëmundje e keqe!”*

“Sëmundje e keqe” është çdo sëmundje e ligë, e rrezikshme, që ka ndikim të keq për të sëmurin dhe për afërmit, siç është kanceri apo sëmundja Covid-19, që është përhapur muajt e fundit.

9. Prej mburojave preventive të rëndësishme është ajo që ka shënuar Ibën Sunij dhe saktësuar Shuajb Arnauti, se Profeti Muhamed ﷺ ka thënë: “Kush thotë çdo ditë në mëngjes dhe mbrëmje shtatë herë:

HasbijAllahu la ilahe il-la hu, Alejhi tevekkeltu ve Huve Rabbul- arshil-adhim.

“Më mjafton Allahu; s’ka të adhuruar tjetër përveç Tij. Tek Ai jam mbështetur dhe Ai është Zoti i Arshit të madh”, Allahu do t’i mjaftojë që t’ia largojë brëngat e dynjasë dhe të ahiretit”. E ka shënuar

Ebu Davudi mevkuf (4/321). Zinxhirin e këtij hadithi e kanë bërë të vërtetë Shuajb dhe Abdulkadër Arnauti (Zadul- Me'ad, 2/376).

10. Prej mburojave preventive kur'anore të rëndësishme është edhe leximi i dy ajeteve të fundit të sures Bekare çdo mbrëmje. Ebu Davudi ka shënuar nga Ibën Mesudi, i cili transmeton se Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Kush i lexon dy ajetet e fundit të kaptinës Bekare në mbrëmje, i mjaftojnë.”

Bedrudin Ajniu për kuptimin e fjalës “*i mjaftojnë*”, thotë: “Nga të ligat e asaj mbrëmjeje” apo “*nga çdo e keqe*”.

11. Gjithashtu nga mburojat kur'anore preventive të rëndësishme është leximi i ajetit të Kursisë kur shkon për të fjetur. “*Kur e lexon atë, do të kesh një roje nga Zoti dhe nuk të afrohet shejtani derisa të zgjohesh*”. E ka shënuar Buhariu në tregimin e Ebu Hurejrës me shejtanin, kur Profeti ﷺ e kishte autorizuar që të ruante zekatin e Ramazanit.
12. Prej mburojave të rëndësishme, të cilat lexohen nga tri herë në mbrëmje, është edhe duaja profetike:

E'udhu bi kelimatil-lahit-tammati min sherri ma halaka.

“Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut nga sherri (e keqja) që ka krijuar.”

E kanë shënuar Ahmedi (2/290), Nesaiu në *Amelul-jevmi vel-lejleh*, hadithi numër 590, etj..

13. Prej lutjeve profetike dhe mburojave të dobi-shme është ajo që ka shënuar Muslimi nga Abdullah bin Amri, se ai ka thënë: “Prej lutjeve profetike ka qenë: “O Allah! Unë kërkoj mbrojtjen Tënde nga largimi i dhuntive të Tua, ndryshimi i gjendjes shëndetësore, dënimi Yt i papritur dhe nga gjithë hidhërimi Yt!”

Kurtubiu thotë: “Ndryshohet gjendja nga shëndeti në sëmundje, nga paqja dhe siguria në bela”.

14. Prej duave që lexohen në mbrëmje është edhe lutja:

Allahume afini fi bedeni, Allahume afini fi semi, Allahume afini fi besari, la ilahe il-la ente.

“O Zoti im, më jep shëndet në trupin tim! O Zot im, më jep shëndet në të dëgjuarin tim! O Zoti im, më jep

shëndet në të parët tim! S'ka të adhuruar tjetër përveç Teje!”

E kanë shënuar Ebu Davudi (4/324), Ahmedi (5/42) dhe Nesaiu në *Amelul jevmi ve lejleh*, nr. 22, Buhariu në librin e tij *Edeb - el-Mufred*, ndërsa Ibën Bazi në librin e tij *Tufetul-Ahjar*, fq. 26, zinxhirin e këtij hadithi e ka bërë të mirë (hasen).

Kuptimi: “O Zoti im, më jep shëndet në trupin tim”, domethënë nga sëmundjet e këqija dhe viruset që e dobësojnë shëndetin për të bërë adhurim.

15. Prej mburojave të lehta me ndikim madhështor janë trespihet dhe istigfari, domethënë kërkimi i faljes. Kush vepron kështu në vazhdimësi, e ruan Allahu nga të këqijat, të ligat, sprovat e fatkeqësitë. Allahu thotë:

﴿ وَمَا كَانَ اللَّهُ مُعَذِّبَهُمْ وَهُمْ

يَسْتَغْفِرُونَ ﴾

“Po Allahu nuk do t’i dënojë ata, derisa ti (Muhamed) je në mesin e tyre dhe Allahu nuk do t’i dënojë, derisa ata kërkojnë falje (istigfar).” [Enfalë: 33]

Allahu thotë për Junusin a.s.:

﴿ فَلَوْلَا أَنَّهُ كَانَ مِنَ الْمُسَبِّحِينَ ﴾

“E sikur të mos ishte ajo që ai kishte qenë prej atyre që shumë e përmendin Zotin.”

[Saffat: 143]

Taberiu thotë: “Ai e ka përmendur dhe kujtuar Zotin para sprovës, prandaj Allahu e ka përkujtuar në kohën e sprovës dhe e ka nxjerrë duke e shpëtuar.”

16. Muslimi ka shënuar në sahihun e tij nga Havle bint Hakimj, se ka thënë: “Kam dëgjuar Pejgamberin ﷺ duke thënë: “Kush hyn në një vendbanim e pastaj thotë:

E’udhu bi kelimatil-lahit-tammati min sherri ma halaka.

“Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut nga sherri (e keqja) që ka krijuar”, nuk i bën dëm asgjë përderisa të largohet nga ai vend.”

E kanë shënuar Ahmedi (2/290), Nesaiu në *Amelul-jevmi vel-lejleh*, hadithi numër 590 etj..

17. Gjithashtu prej duave profetike mbrojtëse është edhe lutja e mëposhtme:

Allahumeahfedhni min bejni jedejje ve min halfi ve an jemini ve an shimali ve min fevki ve eudhu bike en ugtale min tahti.

“O Zot, më ruaj nga para dhe prapa, në të djathtë, në të majtë dhe nga lart. Kërkoj nga Ti që të më mbrosh të mos më lëshojë toka!”

E kanë shënuar Ebu Davudi dhe Ibën Maxheh (shih *Sahih ibën Maxheh*, 2/332).

18. Enes bin Maliku ka thënë: “I Dërguari i Zotit ﷺ ka thënë: “*Bamirësi është i mbrojtur nga të këqijat, të ligat, fatkeqësitë. Bamirësit e dynjasë janë bamirësit e ahiretit.*”

Prej dobive të hadithit është se kush u bën mirë njerëzve, e mira do t'i kthehet në dynja dhe e ruan Zoti nga fatkeqësitë.



UDHËRRËFYES I RËNDËSISHËM KUR ZBRESIN SËMUNDJET

1. Besimi në kader, e mira dhe e keqja, është shtyllë e imanit dhe sekret i Allahut në krijesat e Tij. Besimtari duhet të jetë i kënaqur me caktimin e Allahut, por të përmbahet dhe të mos hidhërohet e të mos ankohet. Çdo gjë që e godet njeriun, si sëmundje, katastrofa e fatkeqësi, është me caktimin e Allahut. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿ مَا أَصَابَ مِنْ مُصِيبَةٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ ۗ وَمَنْ يُؤْمِن بِاللَّهِ
يَهْدِ قَلْبَهُ ۗ وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴾

“Çfarëdo e keqe që ndodh (godet), nuk mund të jetë ndryshe vetëm sipas caktimit të Allahut, e kush i beson Allahut, Ai ia udhëzon zemrën e tij; Allahu është i gjithëdijshëm për çdo send.” [Tegabun: 11]

Hasen el Basriu ka thënë: *“Allahu ka krijuar krijesat, ka ndarë exhelet (afatizuar), ka ndarë rizikun (furnizimin), por edhe sprova dhe shërimi të gjitha janë me kader (caktim).”*

2. Domosdoshmëria e besimit të plotë dhe bindja e thellë se Allahu është Ai që e lejon të mi-

rën dhe të keqen që të ndodhin, Ai jep dhe ndalon, është Shëruesi dhe Ruajtësi. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿ وَإِنْ يَمْسَسْكَ اللَّهُ بِضُرٍّ فَلَا كَاشِفَ لَهُ إِلَّا هُوَ ۗ ﴾

“Nëse Allahu të godet me ndonjë të keqe, s’ka kush që ta largojë atë pos Tij.” [Enam: 17]

Allahu thotë për fjalët e Ibrahimit a.s.:

﴿ وَإِذَا مَرَضْتُ فَبُهِتَ الَّذِينَ الْأُولَىٰ يَخْتَفُونَ ﴾

“Dhe kur të sëmurem, A më shëron.”

[Shuara: 80]

3. Kthimi te Zoti, mbështetja tek Allahu në të gjitha sferat e jetës. Nuk duhet të mbështetemi te vetja dhe forca jonë, por duhet të dimë se s’ka lëvizje e as forcë përveçse me dëshirën e Allahut. Çfarë do Ai, bëhet dhe çfarë nuk do, nuk realizohet. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿ وَعَلَى اللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُتَوَكِّلُونَ ﴾

“Vetëm Allahut le t’i mbështeten vazhdimisht ata që gjithnjë i mbështeten.” [Ibrahim: 12]

4. Dijetarët, thirrësit, nxënësit e dijes, të mençurit duhet të ngrenë moralin e njerëzve, të ko-

munikojnë me optimizëm për kohën e krizës. Le t'i qetësojnë njerëzit, t'ua lehtësojnë e mos t'i frikësojnë dhe asnjëherë të mos e përshkruajnë gjendjen si të trishtueshme për të mbjellë frikë dhe panik. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿ إِذْ هُمَا فِي الْغَارِ إِذْ يَقُولُ لِصَاحِبِهِ لَا تَحْزَنْ إِنَّ اللَّهَ مَعَنَا ﴾

“Kur ishin në shpellë, ai (Muhamedi) i tha shokut të vet (Ebu Bekrit): “Mos u brengos, vërtet Allahu është me ne!” [Teube: 40]

Në rrëfimin e Musait, paqja qoftë mbi të, në Kur'an thuhet:

﴿ لَا تَخَفْ ۗ نَجَّوْتُمْ مِنَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴾

“Mos ki frikë, paske shpëtuar nga populli zullumqar!” [Kasas: 25]

Pejgamberi Muhamed ﷺ ka thënë: *“Më pëlqen optimizmi i mirë, e ajo është “fjala e mirë”.*”

5. Bindja dhe imani se sëmundja nuk shpërnda-het me ndikimin e saj, por me urdhrin e Allahut dhe forcën e Tij duke pasur parasysh edhe shkaqet materiale mjekësore e preventive nga largimi i shkaqeve të sëmundjeve, vendeve të

infektuara dhe marrja në konsideratë e të gjitha këtyre udhëzimeve.

6. Kujdesi nga informatat e rreme dhe bartja e lajmeve pa i konfirmuar dhe verifikuar, sidomos ato që përhapin frikë dhe panik në popull. Njerëzit duhet të largohen nga deklaratat apo analizat e joprofesionistëve, pasi informatat merren vetëm nga burimet zyrtare.

Allahu i Madhëruar tregon për cilësitë e hipokritëve:

﴿ وَإِذَا جَاءَهُمْ أَمْرٌ مِّنَ الْأَمْنِ أَوْ الْحُوفِ أَدَّعَوْا بِهِ ۖ وَلَوْ رَدُّوهُ إِلَى الرَّسُولِ وَإِلَىٰ أُولِي الْأَمْرِ مِنْهُمْ لَعَلِمَهُ الَّذِينَ يَسْتَنْبِطُونَهُ مِنْهُمْ ﴾

“Kur t’u vijë atyre ndonjë lajm i rëndësishëm që i përket sigurisë ose frikës, ata e përhapin atë, por në qoftë se ata këtë lajm ia përcjellin Pejgamberit dhe parisë (bashkëpunëtorëve të afërm të tij) do të kuptonin prej tyre vetëm atë, që dëshirojnë ta marrin vesh.” [Nisa: 83]

7. Lidhja për Allahun dhe forcimi i lidhjes me Të. Le të shpejtojmë në përgjigjen e zbatimit të urdhrave, të shpeshtojmë istigfarin, pendimin, të largohemi nga mëkatet, gabimet dhe mendimi i mirë për Allahun. Nuk zbrit fatke-

qësia veçse për shkak të mëkatit dhe nuk largohet veçse me pendim.

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿ظَهَرَ الْفَسَادُ فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ بِمَا كَسَبَتْ أَيْدِي النَّاسِ لِيُذِيقَهُمْ
بَعْضَ الَّذِي عَمِلُوا لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ﴾

“Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të kësaj të keqeje që e bënë, ashtu që tërhiqen (nga të këqijat).” [Rum: 41]

8. Sëmundjet infektive janë një lloj dënimi nga Zoti, që Zoti e dërgon për të ndëshkuar jobsimtarët dhe mëkatarët, ndërsa për besatarët është shpëtim, mëshirë dhe ngritje në shkallë për t’u shlyer mëkatet e njerëzve. Kur Aishja e pyeti të Dërguarin e Allahut për murtajën, ai tha: “Ajo është dënim nga Allahu, e dërgon ku të dojë dhe Allahu e ka bërë mëshirë për besimtarët. Nuk ndodh që të vijë murtaja në një vend e njeriu të izolohet aty duke shpresuar në shpërblimin e durimit, e di që nuk ndodh diçka vetëm atë që ka shkruar Allahu, veçse e ka shpërblimin e njëjtë me të dëshmorit.” (Transmeton Buhariu)

9. Rrezikshmëria e monopolit, ngritjes së çmimeve dhe loja me artikujt thelbësorë të nevojave ditore që kanë njerëzit në kohë krizash. Ky veprim llogaritet haram si fitim i paligjshëm, mashtrim dhe është shenjë e cilësive të ulëta njerëzore, sjellje jo korrekte dhe njerëz me iman të dobët e të ligë. Pejgamberi Muhamed ﷺ ka thënë: “*Vetëm një gabimtar bënë monopol.*” Gabimtari këtu ka për qëllim, mëkatari.
10. Muslimani duhet të marrë mësim nga sëmundjet, fatkeqësitë, sprovat dhe katastrofat duke bërë përpjekjet për t'i larguar ato fillimisht me shkaqe shariatike e më e rëndësishmja është distancimi nga veprat e liga, të ndyra si imoraliteti dhe nga padrejtësia.
- Shënon Ibën Maxhe në Sunenin e tij dhe e ka saktësuar Albani se Pejgamberi ﷺ ka thënë: “*O ju muhaxhirë, me pesë gjëra nëse provoheni, kërkoni mbrojtjen nga Allahu që mos t'i mbërrini ato. Nuk ka mundësi që imoraliteti të shfaqet tek një popull haptazi përveçse tek ata do të shfaqet murtaja (sëmundje ngjitëse) dhe sëmundje të tjera, të cilat nuk kanë qenë të njohura tek paraardhësit e tyre.*”

Ibën Abdul Beri shënon nga Ibën Abasi të ketë thënë: “Nuk shfaqet imoraliteti në një popull, vetëm se do të shfaqen vdekjet e shumta.”

11. Përgjigjja dhe respektimi i udhëzimeve ose vendimeve të institucioneve përkatëse të sigurisë, shëndetësisë, administratës shtetërore e të tjera. Marrja e përgjegjësisë në nivelin më të lartë duke i dhënë përparësi interesit kolektiv përballë atij individual e të ngushtë. Bashkëpunimi i kërkuar me të gjitha institucionet që do të ndihmojë për t’u kthyer jeta në normalitet dhe tejkalimi i krizës.

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ ۖ وَلَا تَعَاوَنُوا عَلَى الْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ﴾

“Ndhmoni njëri-tjetrin në bamirësi dhe devotshmëri dhe mos ndihmoni në mëkat dhe armiqësi!” [Maide: 2]

Zot, ruaji vendet e myslimanëve nga sëmundjet ngjitesë!

Na furnizo me siguri, iman, qetësi, stabilitet! Shëroji të sëmurit muslimanë, shëroji të sprovuarit tanë dhe largo nga ne çdo sëmundje të keqe!

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
FJALA E PËRKTHYESIT	6
Këshilla 1:.....	11
ZOTI YT ËSHTË I PLOTFUQISHËM	11
Këshilla 2:.....	12
MERRNI MËSIM.....	12
Këshilla 3:.....	14
ALLAHU ËSHTË KRIJUESI.....	14
Këshilla 4:.....	15
TI JE ROB I ALLAHUT.....	15
Këshilla 5:.....	17
T'I KTHEHEMI VETES	17
Këshilla 6 :.....	19
ZOTI YT ËSHTË I BUTË.....	19
Këshilla 7:.....	20
NE KEMI NEVOJË PËR ALLAHUN	20
Këshilla 8:.....	22
ADRESA HYJNORE	22
Këshilla 9:.....	24

ÇDO GJË E KA NJË FUND	24
Këshilla 10:	26
DURIMI I MIRË	26
Këshilla 11:	28
OPTIMIZMI ËSHTË BESIM	28
Këshilla 12:	31
BINDJA NË ZOT	31
Këshilla 13:	33
BËHUNI SYÇELË	33
Këshilla 14:	36
ÇFARË HALLI KE	36
Këshilla 15:	38
NËSE DO ZOTI, DO BËHET MIRË	38
Këshilla 16:	40
QIELLI ËSHTË AFËR	40
Këshilla 17:	42
A IA VLEN BARRA QIRANË	42
Këshilla 18:	45
NGA PUNA NDALEMI VETËM KUR TË HYJMË NË XHENET	45
Këshilla 19:	46

KI FRIKË ZOTIN	46
Këshilla 20:	49
KOHA ËSHTË VETË JETA	49
MBUROJAT PARANDALUESE SHERIATIKE PREJ SËMUNDJEVE ABSTRAKTE DHE KONKRETE	52
UDHËRRËFYES I RËNDËSISHËM KUR ZBRESIN SËMUNDJET	64